



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 3795 prot.

B.Curri, më 21. 08.2025

PROJEKT - VENDIM

Nr _____ Datë ____ . 08.2025

“Për Miratimin e Projekt-Idesë për Ndërtimin e Segmentit Rrugor “Ura e Mërturit – Curraj i Epërm’ Me Degëzim “Mulaj – Gëcaj – Qereç”

Këshilli i Bashkisë Tropojë , në mbledhjen e tij të datës ____ .08. 2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbështetje të pika 2 të nenit 8, të nenit 9 pika 1/1 shkronja “b”, nenit 23 pika 4 dhe 14; të Ligjit Nr.139/215 datë 17.12.2015 Për “*Vetëqeverisjen Vendore*”, (i ndryshuar); Ligjit nr 9270 dt 29.07.2004 “*Per sistemin e adresave*” (i ndryshuar); shkronja “F” e pikës 2 të Ligjit 8378 datë 22.07.1998 “*Kodi Rrugore i Republikës së Shqipërisë*”, (i ndryshuar); Ligji Nr.107 datë 31.07.2014 “*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*” (i ndryshuar); VKM Nr.408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*” (i ndryshuar); VKM nr.555 date 07.05.2008 “*Per miratimin e listes perfundimtare te pronave, pyje dhe kullota, qe do te transferohen ne pronesi te njesise se qeverisjes vendore, Komuna Lekbibaj , te Qarkut Kukes*”; VKM 928 date 02.07.2008 “*Per miratimin e listes perfundimtare se inventarit te Pronave te Paluajtshme Shtetore ne Komunen Lekbibaj, te Qarkut te Kukesit*” ; kërkesës së paraqitur nga “*Unioni për Vendlindjen Curraj i Epërm*”, përfaqësuar nga përfaqësues të komunitetit dhe kryepleqtë e zonës të protokolluar pranë Bashkisë Tropojë me nr.3050 Prot. date 07/07/2025 si dhe kërkesës së paraqitur nga “*Unioni për Vendlindjen Curraj i Epërm*” për depozitim projekti i rrugës “*Ura e Mërturit – Curraj i Epërm*” me degëzimet “*Mulaj – Gecaj – Qereç*” të protokolluar pranë Bashkisë Tropojë me nr.3034 Prot. date 04/07/2025

V E N D O S I

1. Miratimin e **projekt-idesë** për ndërtimin e rrugës “Ura e Mërturit – Curraj i Epërm” (me gjatesi 8.22 km) me degëzimet “Mulaj – Gecaj – Qereç” (me gjatesi 6,45 km) , me gjatësi totale 14.67 km sipas projektit dhe relacioni teknik bashkngjitur . Traseja e rruges kalon ne pasurite si vijon

Segmenti Ura e Merturit – Curraj i Epërm: pasuritë nr. 573, 578, 574, 556, 569, 556, 104, 501, 577, 502/902, 502/901, 502/899, 502/898, 502/896, 502/888, 502/889,

502/893, 502/892, 502/891, 502/826, 502/825, 502/977, 502/341 si dhe pasuri qe nuk iu kane nenshtruar akoma rregjistrimin fillestar por jane ne process certifikimi

Degëzimi Qerrec – Mulaj: pasuritë nr. 568, 556, 109, 527, 553, 511/235, 511/232, 511/231, 104, 501, 511/206, 116, 511/207, 221, 511/147, 111, 511/132, 511/77, 347, 346, 511/75, 511/74, 345, 343, 511/70.

2. Financimi i këtij projekti do të synohet përmes përfshirjes në **buxhetin e shtetit** ose **aplikimit për fonde nga organizata zhvillimore dhe donatorë të huaj**, në bashkëpunim me grupin e interesit.
3. Në rast konstatimi të nevojës për shpronësime, ato do të planifikohen dhe realizohen sipas procedurave ligjore në fuqi, në përputhje me **Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm publike”** (i ndryshuar), si dhe aktet nënligjore përkatëse.
4. Te ndiqen te gjitha procedura ligjore qe nevojiten per pajisjen me leje infrastrukture.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas pikës 6 të nenit 55 Ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” dhe pas konfirmimit ligjorë nga institucioni i Perfektit të Qarkut Kukës.
6. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit , Drejtoria Ekonomike dhe Sektori Juridik per zbatimin e ketij vendimi.

Propozues Drejtoria e Sektorit te Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit

T.Kuçana

E.Musaj

E.Muhametaj

Ligjshmeria

F. Votoci

KRYETARI E BASHKISE

REXHE BYBERI

ME AUTORIZIM DHE ME URDHER

Zv/KRYETARE E BASHKISE

ZYRA ISLAMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 3739 prot.

B.Curri, më 21. 08. 2025

Lënda: RELACION.

“Për Miratimin e Projekt-Idesë për Ndërtimin e Segmentit Rrugor “Ura e Mërturit – Curraj i Epërm’ Me Degëzim “Mulaj – Gëcaj – Qereç”

Te nderuar z. keshillettare!

Duke u nisur nga kërkesa zyrtare e paraqitur nga “Unioni për Vendlindjen Curraj i Epërm” dhe komuniteti i zonës, si dhe dokumentacioni teknik i dorëzuar pranë Bashkisë Tropojë, është shqyrtuar mundësia e ndërtimit të një aksi rrugor strategjik për qarkullimin dhe zhvillimin e zonës së thellë Nikaj–Mërtur.

Segmenti në fjalë, me një gjatësi mbi 14.6 km, përfshin ndërtimin e rrugës nga “Ura e Mërturit” deri në “Curraj të Epërm” me dy degëzime dytësore në drejtim të “Mulaj – Gëcaj” dhe “Qereç”.

Projekti është hartuar si një **dhuratë teknike** nga **Grupi i Projektimit** me në krye Inxhinier Agim Qokaj, për të mbështetur zhvillimin infrastrukturor të zonës së thellë Nikaj–Mërtur. Rruga e propozuar lidh zonat e izoluara të Curraj i Epërm me rrjetin rrugor kryesor, duke mundësuar:

- qarkullimin e banorëve,
- zhvillimin e turizmit malor,
- transportin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.

Gjurmët e rrugës janë ndarë në segmente funksionale dhe janë hartuar me vëllime të detajuara për çdo njësi ndërtimi.

ELEMENTËT TEKNIKE KRYESORE

- **Gjatësia totale e rrugës:** mbi 14 600 m
- **Lloji i terrenit:** përfshin formacione gjeologjike eluviale, deluviale dhe shkëmbinj të kategorive III-VI
- **Punime të parashikuara:**
 - Hapje trasesh me makineri dhe me mina (në segmentet shkëmbore)
 - Ndërtim muresh mbajtëse dhe pritëse
 - Shtresë çakulli natyror (sitisje në sitë 100–120 mm)
 - Instalimi i tombinove Ø600 dhe Ø1000 mm
 - Ndërtim urash të tipit “Beli”
 - Bokse betoni 2–3 m të larta për qarkullimin e ujërave

Bashkia Tropojë, në kuadër të procedurave të nevojshme ligjore dhe administrative, ka dërguar për konfirmim dokumentacionin pranë institucioneve përkatëse si më poshtë:

- **Drejtoria Vendore e Kadastrës Kukës**, për përcaktimin e statusit juridik të parcelave të prekura nga trasa e rrugës;
- **Administratori i Njesisë Administrative Lekbibaj**, për verifikimin e pronarëve të prekur dhe marrjen e dakordësisë së tyre mbi realizimin e projektit;
- **Spektori i Pyjeve**, për evidentimin e sipërfaqeve pyjore që preken nga ndërhyrja.

Këto veprime janë ndërmarrë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht:

- Ligjin nr. 111/2018, “Për Kadastrën”;
- Nr.8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik”;
- Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

Konteksti i projektit

Rrugët ekzistuese në zonën e fshatrave të Currajve (si p.sh. **Rruga Curraj i Epërm – Vranë e Madhe**) janë rrugë të vjetra bjeshkësh, të cilat sot paraqesin kushte shumë të vështira kalimi, duke shtrirë gati **40 km në lartësi mbi 1600 m**. Për pasojë, qarkullimi është i kufizuar dhe banorët e këtyre zonave janë të izoluar nga rrjetet kryesore rrugore.

Rruga e propozuar parashikohet të lidhë disa fshatra të Njesisë Administrative Lekbibaj, konkretisht:

Curraj i Epërm, Curraj i Poshtëm, Betoshë dhe Qerrec–Mulaj, duke sjellë përmirësim të ndjeshëm të jetesës së komuniteteve vendase. Kjo ndërhyrje do të mundësojë lidhjen direkte të këtyre fshatrave me rrugën kryesore, duke **shkurtuar ndjeshëm distancën dhe kohën e udhëtimit me automjet**.

Zgjedhja e trasës

Fillimisht, deri në piketën 92, ishte parashikuar që rruga të ndërtohej në anën e djathtë të lumit. Megjithatë, pas diskutimeve dhe verifikimeve në terren nga grupi i punës, u vendos që rruga të mos kalonte në kanalën e hidrocentralit, por të zhvendosej në anën tjetër, në mënyrë që:

- të preken sa më pak toka të pronarëve privatë,
- pjesa më e madhe e rrugës të kalojë në sipërfaqe pyjore dhe toka të papërdorura,
- të reduktohet ndikimi social dhe ekonomik mbi banorët.

Parcelat e prekura

Nga kjo ndërhyrje preken parcelat si vijon:

- **Segmenti Ura e Merturit – Curraj i Epërm**: pasuritë nr. 573, 578, 574, 556, 569, 556, 104, 501, 577, 502/902, 502/901, 502/899, 502/898, 502/896, 502/888, 502/889, 502/893, 502/892, 502/891, 502/826, 502/825, 502/977, 502/341 si dhe pasuri që nuk iu kanë nënshtruar akoma regjistrimin fillestar por janë në proces certifikimi
- **Degëzimi Qerrec – Mulaj**: pasuritë nr. 568, 556, 109, 527, 553, 511/235, 511/232, 511/231, 104, 501, 511/206, 116, 511/207, 221, 511/147, 111, 511/132, 511/77, 347, 346, 511/75, 511/74, 345, 343, 511/70.

Sipas verifikimeve të kryera në terren, rezulton se tokat bujqësore, livadhet dhe kullotat e prekura nga trasa e rrugës ndodhen në këto seksione dhe zona kadastrale:

- **Fshati Curraj i Poshtëm, ZK.1432**
Nga **Seksioni 1** deri në **Seksionin 19** ndodhen në proces certifikimi.
o Gjatësia: **450 ml** dhe Sipërfaqja: **3,240 m²**
- **Fshati Betoshë, ZK.1174**
Nga **Seksioni 21** deri në **Seksionin 27**.
o Gjatësia: **150 ml** dhe Sipërfaqja: **1,720 m²**
- **Fshati Curraj i Epërm, ZK.1431**
Nga **Seksioni 347** deri në **Seksionin 367**.
o Gjatësia: **580 ml** dhe Sipërfaqja: **5,300 m²**
- **Fshati Qereç – Mulaj, ZK.3097**
Nga **Seksioni 205** deri në **Seksionin 347**.
o Gjatësia: **580 ml** dhe Sipërfaqja: **5,300 m²**

Pas marrjes së përgjigjeve zyrtare dhe konfirmimit nga institucionet përkatëse, Bashkia Tropojë do të vijojë me **planifikimin dhe zbatimin e procedurave** sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 20/2020.

Qëllimi përfundimtar është që, pas plotesimit të nevojshme sic është Leja Mjedisore , Oponenca Teknike , regjistrimi përfundimtar të pasurive të paluajtshme që preken nga ky projekt me certifikata pasurie që janë të Bashkisë Tropojë, planifikimi i procedurave të shpronësimit të nevojshëm sipas ligjeve në fuqi, të aplikojë për **Leje Infrastruktura**.

Gjithashtu, realizimi i këtij projekti kërkon **541,011,969 leke** me TVSH, e cila do të synohet përmes:

- përfshirjes në **buxhetin e shtetit**, ose
- aplikimit për **fonde të huaja zhvillimore/donatorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë**, për të siguruar financimin e zbatimit.

Ky relacion paraqitet për miratim si pjesë e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak për këtë projekt të rëndësishëm.

Mirëpresim çdo mendim nga ana juaj !

Faleminderit.

Bashkëlidhur gjeni Plan Rilevimit të gjurmës së rrugës , kërkesën e qytetarëve dhe përfaqësuesve për hapjen e rrugës në fjalë dhe depozimitin e projektit.

Spektori i Urbanistikës:

Ark. Time Kuçana

Ark.Urb. Endrit Musaj

Ing. Egzon Muhametaj

KRYETARI I BASHKISË
Rexhe BYBERI

ME AUTORIZIM DHE ME URDHER
ZV.KRYETARË E BASHKISË
Zyra ISLAMAJ

11. 3. 2024 / 26/
St. 4/7/2025

"Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm"
Rruga "Ganimete Tërbeshi", banesa nr. 16
Njësia nr. 11, Laprakë, Tiranë
Mobile: 0692151021
E-mail: unioni.c.eper.01@gmail.com
dr.lekehysenaj@gmail.com

Selektorit. Unë bashkëpunues
Këshillit Bashkiak.
dat. 04.07.2025
[Signature]

NIPT/NSSH: M42103451Q
NR.LLOG.: 00002169724
IBAN: AL722121 1009 0000 0000 02169724

Nr. 34 / Prot.

Tiranë, më 04.07.2025

Lënda: --Depozitim projekt i rrugës, nga Ura e Mërturit - Curraj i Epërm dhe degëzim Mulaj - Qereç.
Drejtuar: - Këshillit Bashkiak, Tropojë
Për dijeni: - Bashkisë Bajram Curri, z. Rexhë Biberi, Tropojë.

Shoqata **"Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm"** është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 3583, datë 20.05.2013 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Në bazë të statutit të saj kjo shoqatë *"...ka si objektiv sensibilizimin dhe bashkimin e të gjitha potencialeve njerëzore, intelektuale dhe ekonomike të banorëve të trevës Curraj i Epërm"* me qëllim ruajtjen, mbrojtjen e bukurive natyrore, monumenteve të veçanta natyrore, inkurajim dhe zhvillim të turizmit veror dhe dimëror, iniciativave dhe dialogut të hapur me organizma qeveritarë dhe joqeveritarë, grupe interesi dhe gjithë aktorëve komunitarë.

Me kontributin tonë dhe të një grupi inxhinierësh dashamirës të Currajve, pas një pune voluminoze terren-studio u bë e mundur hartimi dhe zbardhja e plotë e projektit **(Dhuratë për bashkinë)** më të mirë të mundshëm për ndërtimin e segmentit rrugor përgjatë rrjedhës lumore **Ura e Mërturit – Curraj i Epërm me degëzimin Mulaj – Gecaj – Qereç**. (Ky projekt ka qenë një lobim i kahershëm, por tani ka marrë formën më të mirë të ekspertizës nga inxh. Kristaq Puleri, ish-drejtori i Institutit të Ndërtimeve dhe Projektmeve në shkallë republike për shumë vite, aktualisht një zë shumë i njohur në fushën e projekteve dhe ndërtimeve, inxh. gjeodet në studion projektuese **Geo Sky, Sokol Çullhaj** dhe inxhinier gjeolog pranë autoritet rrugor shqiptar, **Agim Qokaj**).

Ky segment rrugor ka një gjatësi totale prej 13 km (8 km segmenti për Curraj të Epërm dhe 5 km kryqëzimi Mulaj – Gecaj (Kuç) dhe Qereç – Bira (shpella) e zezë 6.5 km e eksploruar nga speleologë italianë dhe shqiptarë, ndër më të mëdhatë në Ballkan.

Për të qenë sa më të saktë në hartimin e projektit, kemi inspektuar terrenin në pranverë, më 22 dhe 23 mars, 2025, akoma pa u gjelbëruar zona, ku kemi bërë matje topografike, filmime me dron, foto etj., tërë lugina, ura e Mërturit përgjatë lumit Curraj dhe Mulaj-Kuç-Qereç.

Dosja e projektit përmban:

Profilin topografik gjatësor të vendosur mbi ortofoto.

Profilin gjatësor të ndarë në profile tërthore për zbatim, vendosur në terren.

Profilin tërthorë të zbatimit (mbushje, gjermim) etj.

Paraqitje totale e projektit në google me ortofoto.

Paraqitje e projektit mbi hartën e zonës me emërtime të zonave ku kalon rruga.

Paraqitje në 3D e projektit.

Studim i detajuar gjeologjik.

Përshkrim i punimeve, ndarë në disa segmente.

Preventiv paraprak me çmime online, marrë nga E-Albania.

Prerje tërthore dhe vizatime për veprat e artit (Bokse, tombino, mure pritëse dhe mbajtëse).

Materialet për projektin janë bashkëngjitur ne CD

Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm

Sekretari
Dedë Qokaj

[Signature]

Nënkryetari
Ingj. Agim Qokaj

[Signature]



"Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm"

Rruga "Ganimete Tërbeshi", banesa nr. 16

Njësia nr. 11, Laprakë, Tiranë

Mobile: 0692151021

E-mail: - dr.lekehysenaj@gmail.com

- unioni.c.eper.01@gmail.com

Nr. 33 / Prot.

Tiranë, më 16.11.2024

Dëgjese publike - kërkesë

Drejtuar: - Bashkisë Bajram Curri, Tropojë.

- Enkas Këshillit bashkiak, Tropojë.

Për dijeni: - Njesisë Administrative, Lekbibaj

Lënda: Dëgjese publike dhe kërkesë për miratim projekti dhe çelje fondi për fillimin e rrugës së makinës Ura e Mërturit - Curraj i Epërm, Mulaj – Qereç.

Sot, më 16.11.2025 u mbledh komuniteti Curraj i Epërm, Qereç-Mulaj nën drejtimin e shoqatës "Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm", si person juridik, me objekt:

1. Dëgjese publike për projektin e rrugës automobilistike, mendimi alternativ, sensibilizimi dhe lobimi ndaj institucioneve zyrtare të shtetit për çelje fondi për fillimin e rrugës nga ura e Mërturit, rrjedhës së lumit e gjer në Curraj të Epërm, me degëzim edhe Mulaj-Qereç.
2. Çështja e regjistrimit të pronave, maj-qershor, 2024, mangësi sipas kërkesë-ankesave dhe propozime konkrete drejtuar institucioneve të linjës me qëllim hipotekimin e plotë sipas përkatësisë së çdo trugu familjar.

Së pari, në emër të këtij komuniteti, përshëndetet fort bashkia Bajram Curri dhe këshilli bashkiak i saj që, më në fund, ka përfshirë në axhendën e vet procedurën ligjore për dëgjese publike të projektit për rrugën Curraj i Epërm dhe miratimin e fondit financiar që fillimi i rrugës, një moment historik për banorët e këtyre trevave, të marrë jetë me zbatimin në terren.

Së dyti, u shpreh falënderimi edhe për regjistrimin dhe konfirmimin zyrtar të hartografisë zyrtare sipas subjekteve pronësore gjatë deklarimit, edhe kjo një tjetër nismë shumë pozitive e ASHK-së, Tiranë.

Së treti, megjithë angazhimin zyrtar përmes ekspertëve përkatës, nga ballafaqimi me terrenin dhe hartografinë e Kadastrës Digjitale, Tiranë, kanë dalë goxha mangësi, si: moskonfirmim i disa trojeve, tokës arë etj., edhe pse e poseduar tash 300 vjet, të cilat figurojnë tokë shtet në dispozicion të bashkisë, diçka surprizuese, siç e shprehën disa familje që janë fshirë tërësisht si qenie pronësore, edhe pse kanë jetuar dhe punuar aty 7-8 breza. Ndaj në këtë pikë u sugjerua që këshilli bashkiak ta zgjidhë me vendim të veçantë këtë çështje delikate për të ardhmen dhe investimet në zonë sipas ligjit 20/20 dhe ligjit 7501, 1991, përcaktimin e saktë

të parcelave tokë arë, pemëtores dhe kullotë, duke evidentuar tërë poseduesit e pronave të tilla që nga 1946, periudha e monizmit dhe privatizimin pas viteve 1990, ballafaquar me ligjet e sipërpërmendura.

U shpreh besimi se bashkia Bajram Curri, këshilli bashkiak i saj, do sjellë në vëmendje serioze këtë trevë turistike, një habitat i harruar tash 30 vite demokraci, së pari me rrugën e makinës, që boria e saj të kumbojë sa më shpejt në qendër të fshatit, çka mori dakordësi dhe mbështetje të fuqishme nga dëgjesa publike dhe në vijimësi çështje të tjera infrastrukturore që dikton zhvillimi i fsatrave Curraj i Epërm dhe Qereç - Mulaj.

Bashkëngjitur janë projektet që ka hartuar Unioni me studio të ndryshme, ndërtimi gjeologjik i segmentit rrugor Curraj i Poshtëm - Curraj i Epërm, relacion teknik i rrugës, video etj., prezantuar më parë pranë Bashkisë Suaj dhe institucioneve të tjera shqiptare, por edhe FShZh-së, madje dhe trupit diplomatik të akredituar në Tiranë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

Unioni për vendlindjen Curraj i Epërm

Sekretari
Dedë Qokaj



Nënkryetari
Agim Qokaj



Kryetari
Lekë Hysenaj



Dëgjuesë publike dhe kërkesë bashkisë dhe këshillit bashkiak, Tropojë për rrugën Curraj i Epërm nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të "Unionit për vendlindjen Curraj i Epërm", më 16.11.2024

Nr	Emri, atësia dhe mbiemri	ID	Telefoni	Nënshkrimi
1	Dede' Nilitë Qokaj	60607067	0684149409	Dede' Nilitë
2	Qelash Gecaj		0682757818	Qelash
3	Erëll Ilazori Hishaj		0682410931	Erëll
4	Erën Jon Vukaj		0672089044	Erën
5	Dede' Ahmet Vukaj		0697238458	Dede'
6	Isaier Nilitë Gecaj		0682524056	Isaier
7	Zef Mark Datinaj		0684600219	Zef
8	Vatë Mirash Geci		0682646513	Vatë
9	Genolin Doder		0682125268	Genolin
10	Agim Dede		0682125268	Agim
11	Isaier Dede		0682125268	Isaier
12	Isaier Mirash Ndocenti		0695868433	Isaier
13	GOK Zefi Mirash		0692779806	GOK
14	Nikoll Vukaj		0682363476	Nikoll
15	Zef Dodi Gecaj		0683144154	Zef
16	Genim FRAN PREBIBAJ		0684039999	Genim
17	Ndoci Gecaj		0688251764	Ndoci
18	Dokol Petr Qokaj		0694102344	Dokol
19	Lazer Vjeker Qokaj	970806040 D.	0694135820	Lazer
20	PRELE DOD QOKAJ	H402220675	0686260782	PRELE
21	Ndoci Doder		0697068281	Ndoci
22	Mark Ndoci Mirash		0682126158	Mark
23	Gjergj Gecaj		0682357508	Gjergj
24	Relë Arif Geci		0673000428	Relë
25	Lush Gecaj	0694100106	0684329777	Lush
26	Antonshan Prebibaj	0682030880		Antonshan
27	Nikolinshan Prebibaj		0695621750	Nikolinshan
28	Shan Prebibaj		0682030880	Shan

Sekretari
Dede' Qokaj

Nënkryetari
Agim Qokaj

Kryetari
Lekë Hysenaj

(Signature)

(Signature)



Dëgjuesë publike dhe kërkesë bashkisë dhe këshillit bashkiak, Tropojë për rrugën Curraj i Epërm nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të "Unionit për vendlindjen Curraj i Epërm", më 16.11.2024

29	Ded Mark & Nure	0672016314	
30	ARON NIKOQA / H/103010	0646/0693360009	
31	Name Zazel Qokaj	068240727	
32	Pal Marash Hekaj	0682895986	
33	Tran Nikoll Mulej	0692131834	
34	Opol Nikoll Qokaj	0685626671	
35	Arin (Dad) Qoka	0685464866	
36	Zego Mark Prohishaj	0684805759	
37	Lesh Grime Prohishaj		
38	Viktor Roman Gecaj	0682386707	
39	Arbush Zef Gecaj	0682895725	
40	Nelca Mark Nishitaj	0698983522	
41	Gloria Vashitaj	0683348960	
42	Pjete Vato Haxhemaj	069295555	
43	Aleksandere Qokaj	0685808499	
44	Arin Dad Nurej	0699645131	
45	Arif Haxhemaj	0685790675	
46	Georj Haxhemaj	0676510988	
47	Agim Martin Haxhemaj	0693011250	
48	Velis Gjeter Haxhemaj	0682401060	
49	Arbush Haxhemaj	069251021	
50	Arin Gecaj	0684522789	
51	Agim Nikoll Qoka	0682266686	
52			
53			
54			
55			
56			
57			

Sekretari
Dedë Qokaj

Nënkryetari
Agim Qokaj

Kryetari
Lekë Hysenaj



PREVENTIV

EMERTIMI I OBJEKTIT: Seg. Rrugorë Ura e Mërturit - Curraj Epërm

Anal	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
	SEG. 1. Shtëpia e Marsh Manit - Hyrja e Qafes se Pjas (Gjatësia 1700ml)				
3.101/b	Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria	m³	23800	190.28	4,528,664
3.124/3a	Germim shkambi me mina te vogla dhe ,me ekskavator 1 m3 + transport	m3	2300	1,428.8	3,286,309
An	Ure Beli	ml	25	500,000	12,500,006
An	Vendosje bokse 2.5 x 3 , ml	ml	6	189,661.87	1,076,572
An	Vendosje bokse 2. x 3 , ml	ml	6	179,042.40	1,074,254
3.364	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (6 copë)	ml	36	6,138.92	221001.12
3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni (3 cope)	m	18	15,402.89	277,252.02
3.21	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m²	11900	873.67	10,396,673
3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur mbajtës)	m3	270	17,483	4,720,380
3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur prites)	m3	200	17,483	3,496,578
3.396	Mbushje me çakell pas mureve	m3	675	1,049	708,358.500
	shuma I				42,286,048
	SEG. 2 Shkëmi Qafë së Pjas - Shpella e Guknit (900ml)				
3.124/3a	Germim shkambi me mina te vogla dhe ,me ekskavator 1 m3 + transport	m3	15600	1,428.8	22,289,748
3.364	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (2 copë)	ml	12	6,138.92	73,667.04
3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni (1cope)	m	6	15,402.89	92,417.34
3.21	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m²	5400	873.67	4,717,818

3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur mbajtes)	m3	390	17,483.00	6,818,370
An	Vendosje bokse 2 x 3 , ml (dy copë)	ml	12	179,042.40	2,148,509
	shuma II				36,140,529
	SEG. 3 Shpella e Guni - shkambi poshte Mulajve. 1200 ml				
3.101/b	Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategorizim	m ³	11600	190.28	2,207,248
3.124/3a	Germim shkambi me mina te vogla dhe ,me ekskavator 1 m3 + transport	m3	5200	1,429	7,429,916
3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m ²	7200	873.67	6,290,424
3.364	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (3copë)	ml	18	6,138.92	110,501
3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni (2 cope)	ml	12	15,402.89	184834.68
An	Vendosje bokse 2 x 3 , ml (dy copë)	ml	12	179,042.40	2,148,509
3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	250	1,049.42	262,355
3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur prites)	m3	900	10,531.45	9,478,305
4.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur mbajtes)	m3	650	17,483.00	11,363,950
	shuma III				39,476,042
	SEG. IV Shkambi posht Mulajve. 500ml				
3.124/3a	Germim shkambi me mina te vogla dhe ,me ekskavator 1 m3 + transport	m3	6300	1,428.8	9,001,629
3.364	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (1copë)	ml	6	6,138.92	36,834

3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m ²	3000	873.67	2,621,010
4.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur mbajtes)	m ³	200	17,483.00	3,496,600
An	Vendosje bokse 2 x 3 , ml (dy copë)	ml	12	179,042.40	2,148,509
	shuma IV				17,304,581
	SEG. V. Nga Mulaj deri ne rraget e nengurit. 2600ml				
3.98/b	Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategorizim	m ³	29400	258.63	7,603,722
3.124/3a	Germim shkambi me mina te vogla dhe ,me ekskavator 1 m ³ + transport	m ³	14280	1,428.83	20,403,692
3.365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (3 copë)	ml	18	6,138.92	110,501
3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni (3cope)	m	18	15,402.89	277,252
3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m ²	15600	873.67	13,629,252
3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m ³	1200	1,049.42	1,259,304
3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur prites)	m ³	1560	10,531.45	16,429,062
4.246	Struktura monolite betoni C 20/25 (mur mbajtes)	m ³	2340	17,483.00	40,910,220
An	Ure Beli	ml	33	500,000.22	16,500,007
	shuma V				117,123,012
	SEG. V. Rrëgallet e nën gurit + hyrje daljet . 620ml				
3.98/b	Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m ³ , ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategorizim	m ³	7130	258.63	1,844,032
3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni (2cope)	m	12	15,402.89	184,835
3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m ²	3720	873.67	3,250,052

3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	250	1,049.42	262,355
3.246	Struktura monolite betoni me cakell C 20/25 (mur prites)	m3	200	10,531.45	2,106,290
4.246	Struktura monolite betoni C 20/25 (mur mbajtes)	m3	324	17,483.00	5,664,492
	shuma VI				13,312,056
	SEG. V. Nga Ura e poshtër deri tek lapidari. 700ml				
3.352	Mbushje me gur kave deri në 2m	m³	8400	2,957.35	24,841.74
3.87/b	Germim dheu me ekskavatorme goma 0.25m3 ne kanal gjeresi>2m tok zakonkat III	m³	11138	281.84	3,139,106
3.365	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (2 copë)	ml	12	6,138.92	73,667
3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m²	1680	873.67	1,467,766
3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	100	1,049.42	104,942
3.246	Struktura monolite betoni me cakell C 20/25 (mur prites)	m3	150	10,531.45	1,579,718
An	Ure Beli	ml	32	500,000	16,000,007
	shuma VII				22,390,047
	Shuma I, II, III, IV, V, VI, VII				288,032,315
	Fondi rezerve 5%				14,401,616
	TVSH 20%				57,606,463
	Shuma totale				360,040,394

Çmimet janë marrë nga manuali onlain në E- Albania për vitin 2024

3,673,882
EU

Preventivoi Inxh. Kristaq Puleri; Inxh. Agim Qokaj; Inxh. Sokol Qullhaj

PREVENTIV					
EMERTIMI I OBJEKTIT: Seg. Rrugorë Mulaj - Qeresh					
Anal	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
	SEG. I. K.shtajza - Kodra e Termës (Gjatësia 2200ml)				
3.101/b	Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria	m³	28000	190.280	5,327,840
3.124/3a	Germim shkemb sek i lire, me mina te vogla, me ekskavator 1 m3 + transport	m3	2800	1,428.83	4,000,724
3.364	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (4 copë)	ml	24	6,138.92	147,334
3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni (2 cope)	m	12	15,402.89	184,835
3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m²	3690	873.67	3,223,842
3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	500	1,049.42	524,710
4.246	Struktura monolite betoni C 20/25 (mur mbajtes)	m3	800	17,483.00	13,986,400
3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur prites)	m3	450	17,482.89	7,867,301
	shuma I				32,039,143
	SEG. 2 Degezimi per Mulaj 350ml				
3.101/b	Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria	m³	4900	190.28	932,372
3.364	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (2 copë)	ml	12	6,138.92	73,667
3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m²	620	873.67	541,675
3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	62.5	1,049.42	65,589
4.246	Struktura monolite betoni C 20/25 (mur mbajtes)	m3	112.5	17,483.00	1,966,838
3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur prites)	m3	250	17482.89	4,370,723
An	Vendosje bokse 2 x 3 , ml	ml	6	17,904.24	107,425
	shuma II				7,451,024

	SEG. 3 Nga kodra e termës deri tek ortegu ne Lug te Selbices. 1500 ml				
3.101/b	Germim dheu me ekskavator zinxhir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria	m³	21000	190.28	3,995,880
3.364	Tombino me tuba betoni Ø 600, mbi shtrese betoni (2copë)	ml	18	6,138.92	110,501
3.367	Tombino me tuba betoni Ø 1000, mbi shtrese betoni (1 cope)	m	6	15,402.89	92,417
3.210	Sntresë çakull mbeturin(natyrorë) t=20cm x 2 shtresa 40cm total	m²	2700	873.67	2,358,909
3.396	Mbushje me cakell pas mureve	m3	650	1,049.42	682,123
4.246	Struktura monolite betoni C 20/25 (mur mbajtes)	m3	580.0	17,483.00	10,140,140
3.246	Struktura monolite betoni me çakell C 20/25 (mur prites)	m3	900	17,482.89	15,734,601
An	Vendosje bokse 2 x 3 , ml	ml	6	179,042.40	1,074,254
	shuma IV				31,829,916
